



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT  
DREJTORATI PËR ARSIM



ME DATË: 09.10.2019, NR. 09-610-58880

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në Nenin 79 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe bazuar në Nenin 7, 12,13,14,15 të Rregullores me nr. 320-19338, dt. 07.04.2017 të Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogocit) për kushtet , kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Drejtori i Drejtoratit për Arsim,shpall:

## KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE

### PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË DRENASIT

Komuna e Drenasit ndanë 160 bursa për studentët e kësaj komune që studiojnë në universitetet publike të Kosovës në vitin akademik 2019-2020 në të gjitha fakultetet apo drejtimet e studimit (megjithëse vetëm studentët e disa fakulteteve marrin pikë bonus). Vetëm studentët e rregullt të nivelit Baçelor kanë të drejtë konkurrimi për fitimin e bursës komunale. 160 bursa do të ndahen për studentët e nivelit Baçelor. Lartësia e bursës komunale për një student është 500 euro.

#### Kushtet për konkurrim për bursë komunale

Kandidati duhet:

1. Të jetë banor i Komunës së Drenasit.
2. Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2019-2020 në ndonjërin nga universitetet publike të Kosovës.
3. Të jetë student i nivelit Baçelor.
4. Të mos ketë përsëritur (humbur) vitin akademik.
5. Të mos jetë në marrëdhënie pune me pagesë me orar të plotë.
6. Të mos jetë përfitues i bursave tjera për vitin akademik shkollor 2019/2020.

## Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të bursave komunale

Përzgjedhja e përfituesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuara në tabelën e mëposhtme. Nëse një kandidat bie në më shumë se një nga kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Megjithëse vlejnë kriteret e njëjta, studentët e nivelit Baçelor konkurrojnë ndaras, brenda kategorisë së vet, sipas kuotave të përmendura më sipër. Nëse kandidatët mbesin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi kategorive ashtu siç janë të renditura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Nota mesatare në studime 10.00 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 5.00)	100
	Nota mesatare 9.50 – 9.99 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 4.67 – 4.99)	95
	Nota mesatare 9.00 – 9.49 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 4.34 – 4.66)	90
	Nota mesatare 8.50 – 8.99 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 4.00 – 4.33)	85
	Nota mesatare 8.00 – 8.49 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 3.60 – 3.99)	80
	Nota mesatare 7.50 – 7.99 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 3.20 – 3.59)	75
	Nota mesatare 7.00 – 7.49 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 2.80 – 3.19)	70
	Nota mesatare 6.50 – 6.99 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 2.40 – 2.79)	60
	Nota mesatare 6.00 – 6.49 (për studentët e vitit të parë pa nota – nota mesatare në klasën XII – 2.00 – 2.39)	50
2	Student bonjak (pa të dy prindërit)	40
3	Student me nevoja të veçanta	30
4	Student nga familja me ndihmë sociale	20
5	Student – fëmijë i dëshmorit të UÇK-së	20
6	Student – invalid i luftës së UÇK-së	15
7	Student – veteran i luftës së UÇK-së	10
8	Student – fëmijë i invalidit të luftës së UÇK-së	10
9	Student – fëmijë i veteranit të luftës së UÇK-së	5

10	Student i gjinisë femërore	5
11	Student që studion më shumë se një drejtim studimi – mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Doktoratë) përveç studimeve Baçelor ose Master	5
12	Student që ka edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtar i tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoratë)	5
13	Student në Fakultetin e Mjekësisë	5
14	Student në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5
15	Student në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore	5
16	Student në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë	5
17	Student në Fakultetin e Edukimit	5
18	Student në Fakultetin e Gjeoshkencave, Xehetarisë dhe Metalurgjisë	5
19	Student në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	5
20	Student në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	5

Vetëm studentëve që janë në vitin e parë të studimeve Baçelor dhe ende nuk kanë nota gjatë studimeve ju llogaritet nota mesatare e klasës së dymbëdhjetë e shkollës së mesme të lartë.

Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

**Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente**

**Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në DKA) ose shkarkohet nga faqja e komunes.
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Ekstrakti i lindjes ose Certifikata e lindjes.
- Kartela Identifikuese e studentit.
- Vërtetimi nga universiteti publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se kandidati është student i rregullt në nivelin e studimeve Baçelor në vitin përkatës të studimeve, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve, që kandidati e ka të regjistruar vitin akademik 2019-2020 dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik.
- Certifikata e notave të studimeve (kandidatët që janë në vitin e parë të studimeve Baçelor dhe që nuk kanë nota në studime duhet të sjellin dëshmi nga fakulteti që ende nuk kanë nota dhe duhet të sjellin Certifikatën e notave të klasës së fundit të shkollës së mesme të lartë.
- Pasqyra e llogarisë nga Trusti pensional deri në datën e nxjerrjes.
- Vërtetim se nuk është përfitues i bursës studentore për vitin akademik 2019-2020.

**Kandidatët që bien në kategoritë tjera të sipër-përshkruara në tabelë duhet të dorëzojnë:**

- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 2 – certifikatat e vdekjes së të dy prindërve.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 3 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 4 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe Certifikatën familjare.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 5 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe Certifikatën familjare.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 6 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 7 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 8 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe Certifikatën familjare.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 9 – dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe Certifikatën familjare.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 11 – dëshminë zyrtare nga universiteti publik.
- Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 12 – dëshminë zyrtare nga universiteti publik për anëtarin e familjes dhe Certifikatën familjare.

**Sqarime shtesë:**

Të gjitha dokumentet që dorëzohen me rastin e aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen për t'u konfirmuar të dhënat vetëm për kandidatët që përzgjidhen si përfitues të bursave.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

**Afati dhe mënyra e aplikimit:**

Konkursi është i hapur prej datës 09 Tetor 2019 deri më 23 Tetor 2019. Aplikacionet pranohen çdo ditë pune prej orës 09:00 – 15:00. Përfituesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë – DKA përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Drenasit.

Drenas,

Më datë: 09.10.2019

